




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (DKRS)

10 / 2018 – zyrtare

Date: 17.07.2018

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (DKRS) në bazë të rregullores 04/2017 rreth kriterëve, procedurave dhe standarteve të financimit publik të OJQ-ve, miraton këtë :

NJOFTIM

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ju njofton se është anuluar Thirrja Publike, në fushën e Rinisë, për mbështetje financiare për projektet/programet që kontribuojnë në zbatimin e Planit të Veprimit Lokal për Rini 2018-2020 të Komunës së Gjakovës i cili i dedikohet fuqizimit të interesave rinore, publikuar me datë 31.05.2018, me titull:

2.OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projektet/programet e tyre për fushat prioritare si në vijim:

a.Të gjitha OJQ-të në Komunën e Gjakovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e Rinisë.

Pas përfundimit të shqyrtimit të të gjitha aplikacioneve të pranuar në kuadër të thirrjes publike, e hapur me datë: 31.05.2018 dhe e mbyllur me: 20.06.2018, për subvencione nga DKRS sipas rregullores 04/2017 rreth kriterëve, procedurave dhe standarteve të financimit publik të OJQ-ve, komisioni vlerësues i aplikacioneve ka rekomanduar të anulohet Thirrja Publike, pasi që OJQ-të që kanë aplikuar, nuk i kanë plotësuar kriteret e Thirrjes Publike, në kompletimin e dokumentacionit të kërkuar me Thirrje Publike.

Komisioni vlerësues i aplikacioneve ka njoftuar OJQ-të, të cilat kanë aplikuar, për plotësim të dokumentacionit me postë elektronike (email), në dy afate kohore: 1. Me 06.07.2018 deri me 10.07.2018, dhe 2. Me 12.07.2018 deri 16.07.2018.

Pas përfundimit edhe të afatit të dytë kohorë, OJQ-të të cilat kanë aplikuar, nuk i kanë plotësuar dokumentacionet e kërkuara, andaj DKRS vendos të anulohet Thirrja Publike e publikuar me datë 31.05.2018.

Me respekt!

Satanda Hyseni, DKRS

KOMUNA E GJAKOVËS

DREJTORIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT

Postal address: Nëna Terezë – Gjakovë, Kosovë / 50000 Tel: +381 390 322 591

kk.rks-gov.net/gjakove/

